

**K O N T R A T E - T H E M E L I M I**  
**I S H O Q E R I S E M E P E R G J E G J E S I T E K U F I Z U A R**  
**"LUFRA" SHPK .**



Ne Tirane , sot me date 19/03/2003 une kerkuesi ARBEN NDREKA kerkoi te rregjistroj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "LUFRA"SH.P.K.

Ky akt hartohet ne baze te ligjit nr.7638 date 19. 11. 1992" Per shoqerite tregetare" dhe te ligjit 7667 date 28.01. 1993" Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare"

H Y R J E

Ortaku i vetem ka te drejta dhe detyrime qe rrjedhin nga veprimtaria e shoqerise.

Qellimi i ketij akti eshte themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "LUFRA" Sh.p.k.

O B J E K T I

Objekti i veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "LUFRA"SH.P.K. do te jete:

- Grumbullim, perpunim e tregetim te bulmetit (qumesht, kos, djath e gjithe nenproduktet e tyre).Import-Eksport.
- Hapje Baxho.
- Tregetim te perimeve dhe artikujve te ndryshem ushqimor. Import-Eksport
- Tregetim makineri e paisje. Import-Eksport.
- Transport te bulmetit e nenprodukteve te tij, perime si dhe artikujve te ndryshem ushqimor. Import-Eksport.

S E L I A

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "LUFRA" SH.P.K. do ta kete seline e saj ne Bishqethëm-Lushnje, dhe me shtrirje ne tere territorin e Republikes se Shqiperise .

Sidoqofte ,selia e shoqerise mund te ndryshohet me vendim te ortakut te vetem dhe te depozitohet ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .



### ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- 1- Ortaku i vetem
- 2- Administratori.

### AFATI

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "LUFRA" SH.P.K. themelohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje periudhe mbi 10 vjet, duke filluar nga koha e regjistrimit ne regjistrin tregetar te Gjykates se Tiranes.

Per shkaqe te arsyeshme ajo mund te mbaroje aktivitetin e saj dhe para ketij afati. Kjo behet ne perputhje me normat e Satutit dhe te legjislacionit ne fuqi.

### KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali baze i Themelimit te shoqerise perbehet nga kapitali themeltar i investuar nga ortakut i vetem Z.ARBEN NDREKA dhe eshte 100.000(njeqinde mije) leke.

Ortaku i vetem eshte pergjegjes ndaj shoqerise me pergjegjesi te kufizuar per te gjitha detyrimet e mara persiper dhe pergjigjet per humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltar.

Fondet monetare te shoqerise mund te perdoren per zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarise se saj ekonomike financiare.

### ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te administrohet nga ortakut i vetem, i cili do te jete edhe administratori i saj, ne perputhje me statutin dhe dispozitat respektive te ligjit 7638 date 19. 11. 1992 " Per shoqerite tregetare".

Rregullat per funksionimin dhe drejtimin e shoqerise jane percaktuara ne Statutin e shoqerise qe shoqeron kete Akt Themelimi.

Te gjitha mosmarreveshjet me organet shteterore , personat juridike e fizike vendas e te huaj,do te zgjidhen nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane. Ky akt themelimi perpilohet ne kater kopje , duke patur secila kopje fuqi te plote ligjore, nenshkruhet regullisht nga ortaku i vetem,me vullnetin e tij te lire dhe te plote.

**ORTAKU I VETEM**

**ARBEN NDREKA**





# STATUT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "LUFRA" SH.P.K.

### HYRJE

#### NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te Kufizuar "LUFRA" sh.p.k.krijohet mbi bazen e iniciatives dhe te kapitalit themeltar te ortakut te vetem Z.ARBEN NDREKA ,i biri Trifonit ,lindur me 08.05.1962, banuese ne BISHQETHËM-LUSHNJE , madhore ,me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, ne baze te aktit te themelimit dt. 19.03.2003 ,per te ushtruar aktivitetin e saj privat si person juridik e i pavarur.

#### NENI 2

Shoqeria ka formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e cila themelohet nga ortaku i vetem .

Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga ky statut,nga dispozitat perkatese te ligjit nr.7638 date 19.11.1992" Per shoqerite tregetare", si dhe nga legjislacioni shqiptar ne fuqi .

Shoqeria do te filloje te veproje siperson juridik qe nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin Tregetar te Shoqerive Tregetare prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane,ndersa veprimtaria ekonomike fillon me regjistrimin ne organet tatimore.

#### NENI 3

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ,i perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

### EMERTIMI , VULA, SELIA, OBJEKTI,KOHEZGJATJA

#### NENI 4

Emertimi i shoqerise tregetare me pergjegjesi te kufizuar eshte "LUFRA" SHPK.

Shoqeria do te kete vulen e saj permbajtja e se ciles do te jete si vijon:

**"LUFRA" SH.P.K.**

Ne te gjitha aktet ose dokumentat qe do te nxjerre shoqeria,shenohet emri i plote i shoqerise ose i shkurtuar,vlera e kapitalit themeltar dhe administratori.

#### NENI 5

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "LUFRA" SH.P.K. do ta kete seline e saj ne BISHQETHEM- LUSHNJE , dhe me shtrirje ne tere territorin e Republikes se Shqiperise .

Sidoqofte ,selia e shoqerise mund te ndryshohet me vendim te ortakut te vetem dhe te depozitohet ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .

#### OBJEKTI NENI 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise "LUFRA" SH.P.K. do te jete:

- Grumbullim, perpunim e tregetim te bulmetit (qumesht, kos, djath e gjithë nenproduktet e tyre).Import-Eksport.
- Hapje Baxho.
- Tregetim te perimeve dhe artikujve te ndryshem ushqimor. Import-Eksport
- Tregetim makineri e paisje. Import-Eksport.
- Transport te bulmetit e nenprodukteve te tij, perime si dhe artikujve te ndryshem ushqimor. Import-Eksport.

#### NENI 7

Shoqeria themelohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje periudhe mbi 10 vjet duke filluar nga koha e regjistrimit ne regjistrin tregetar te Gjykates Tirane.Per shkaqe e arsye te ndryshme, ajo mund te mbaroje aktivitetin e saj para ketij afati.Kjo behet ne perputhje me normat e Statutit dhe te legjislacionit ne fuqi.

#### KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE NENI 8

Kapitali themeltar ishoqerise perbehet nga kontributi i ortakut te vetem Z. ARBEN NDREKA dhe eshte ne shumen 100.000 (njqinde mije) leke.

Kapitali themeltar ndahet ne 100 kuota me vlere 1 000 leke secila kuote.

#### NENI 9

Kapitali i shoqerise depozitohet para fillimit te aktivitetit te shoqerise.



#### NENI 10

Kapitali themeltar mund te shtohet ose te zvogelohet, ne vartesi te rezultateve dhe ne perputhje me normat e legjislacionit te fuqi. Ai mund te jete ne leke ose ne valute te huaj.

#### NENI 11

Kapitali themeltar mund te transferohet jashte Shoqerise , ose te lihet peng ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

#### NENI 12

Kapitali themeltar eshte lehtesisht i transferueshem rruge trashegimie, bashkeshorti, pararardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake ne shoqeri nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit dhe sipas kushteve te parashikuara ne ligj.

#### NENI 13

Shoqeria mund te kete edhe kontribute te tjera ne natyre. Ketu perfshihen te gjitha sendet e paluajteshme ne sherbim te Shoqerise si dhe ato te luajteshme, te cilat kalojne ne pronesi te Shoqerise.

### FONDET E SHOQERISE

#### NENI 14

Shoqeria percakton fondet:

- Fondin themeltar (qarkullues)
- Fondin rezerve
- Fonde te tjera, qe mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise se saj.

Madhesia e secilit fond percaktohet mbi bazen e vendimit te organit drejtues, i cili merr vendim gjithashtu edhe per qellimin e perdorimit te tij.

### DREJTIMI ADMINISTRATIV

#### NENI 15

Shoqeria ka keto organe drejtuese:


1. Asambleja e ortakeve ( Ortaku i vetem )
2. Administratori.

#### NENI 16

Ortaku i vetem ,per administrimin e shoqerise ose te aktiviteteve te vecanta te saj ka kompetence te emeruje nje ose disa persona te tjere si

administratore te Shoqerise.Kompetencat e administratoreve te mundshem percaktohen ne aktin e emerimit te tyre , te leshuar nga ortaku i vetem.

NENI 17



Shoqeria nuk merr persiper veprimet qe mund te kryejne administratore te tjere te mundshem,ne mardhenie me persona te trete qe i tejkalojne kopetencat e tyre te percaktuara ne aktin e emerimit.

NENI 18

E gjithë veprimtaria e shoqerise percaktohet nga administratori i saj ne perputhje me Statutin dhe Legjislacionin ne fuqi.

NENI 19

Ortaku . per te shqyrtuar bilancin vjetor, te ardhurat e qarkulluara ,si dhe menyren e mbajtjes se regjistrave te veprimeve kontabel, emerone nje ose disa eksperte kontabel.Emerimi i eksperteve kontabel eshte i detyrueshem per rastet e parashikuara me ligj.

KOPETENCAT E ORTAKUT TE VETEM

NENI 20

Per sa kohe qe shoqeria do te perbehet nga nje ortak i vetem ,kompetencat e tij do te jene:

- Vendos per ndryshimet ne Statutin e Shoqerise dhe miraton regulloret per sektoret e vecante te saj.
- Emeron dhe shkarkon administratoret dhe percakton kompetencat e tyre ne aktin e emerimit.
- Shqyrton bilancin vjetor ,kuotat e fondeve te ndryshme dhe fitimin e realizuar.
- Vendos per krijimin e filialeve, degeve ose perfaqesive te Shoqerise si dhe per krijimin e shoqerive te perbashketa.
- Vendos per marrjen e kredive si dhe per mbarimin e aktivitetit te Shoqerise,nese ne dokumentacionet financiare , rezultatet e shoqerise vleresohen me humbje.
- Realizon mardheniet me te rendesishme financiare dhe ekonomike te Shoqerise me persona te tjera juridike e fizike.

KOMPETENCATE E ADMINISTRATORIT

NENI 21

Administratori ka per detyre:

- Te punoje ,te drejtoje e te organizoje ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e Shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare.

- Te zbatohet vendimet e marra nga ortakut i vetem dhe urdherat e tij, te dhena brenda kompetencave te percaktuara nga Statuti i Shoqerise dhe legjislacioni ne fuqi.
- Te paraqese ne menyre te regullt raportin e administrimit, te inventarit, bilancit dhe te llogarive vjetore, ortakut brenda nje afati 6 muaj pas mbylljes se vitit financiar pasardhes.
- Realizon dhe percakton cmimet e punimeve dhe sherbimeve te kryera .
- Vendos pagat e personelit te shoqerise .
- Ndjek problemet e Shoqerise ne mardhenie me organe te ndryshme shtetore dhe me persona te tjere juridike e fizike.

MARDHENIET FINANCIARE  
NENI 22

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "LUFRA" sh.p.k. , mund te lidhe kontrata me sektore shtetore ,drejtperdrejt me tregun e lire, si dhe me persona fizike e juridike vendas ose te huaj.

NENI 23

Ne mardheniet kontraktore, Shoqeria perfaqesohet nga ortakut i vetem ose nga persona te autorizuar prej tij. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine.

NENI 24

Shoqeria ka te drejte te cele llogari likujduese prane Bankave te vendit ose te huaja ne Shqiperi ,shtetore ose private dhe te kryeje veprimet e likujdimit nepermjet tre.Per sigurimin e veprimtarise ka te drejte te vetefinancohet ne leke ose ne valute te huaj.

NENI 25

Shoqeria pegjigjet per kontributet fiskale, afatet e derdhjes se tyre dhe sigurimet shoqerore.Personat e ngarkuar me kete detyre duhet te mbajne dokumentacion te rregullt financiar.

Administratori ne fund te vitit duhet te dorezoje ne organin tatimor perkates bilancin e te ardhurave per efekt tatimi vjetor.

Viti financiar mbaron ne muajin dhjetor te cdo viti.Raportet dhe inventaret vjetore hartohen nga ortakut i vetem ne perputhje me dipsozitat e ketij statuti dhe Legjislacionin ne fuqi.

MARDHENIET E PUNESIMIT  
NENI 26

Ortaku i vetem vendos per personat qe do te punesohen ne aktivitetin e Shoqerise. Punesimi do te behet ne perputhje me aftesite profesionale te punemaresit.

#### NENI 27

Mardheniet e punesimit rregullohen sipas kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve , ne baze te kodit te punes dhe akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi.Ne kontrate caktohen kushte e punes ,pageses , sigurimit ne pune , diteve te pushimit etj.

#### NENI 28

Administratori dhe personeli i shoqerise eshte i detyruar te respektoje disiplinën e punes dhe te ruaje dhe te mirembaje pronen dhe te zhvilloje aktivitetin e Shoqersie ne perputhje me ligjin.

#### NENI 29

Ndaj shkeljeve te ndryshme zbatohen disa masa disiplinore qe meren nga ortaku i vetem.Punonjesi qe largohet nga puna duhet te beje dorezimet e detyres ne baze te nje akti me shkrim ,pasi te kete shlyer detyrimet materiale monetare.

### PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

#### NENI 30

Cdo punonjes i punesuar ne Shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres.Ai eshte i detyruar te permbushë detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes,nga vendimet e administratorit dhe nga Statuti i Shoqerise.Per shkelje te tilla dhe per shkelje te legjislacionit ne fuqi meren masa te ndryshme sipas ligjit.

### KONFIDENCIALITETI

#### NENI 31

Te gjithë personat qe do te punesohen ne shoqeri jane te detyruar te ruajne fshehtesine e dokumentacionit ,te informacionit ,te njohurive te fituara si dhe cdo lloj tjeter materiali konfidencial.

Ata duhet te adaptojne te gjitha masat e nevojshme per te parandaluar hapjen e ketyre qofte edhe pjeserisht.

### BILANCI DHE TE ARDHURAT

#### NENI 32



Te ardhurat neto ,pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore dhe detyrimeve te mundeshme ndaj personave te trete ,kalojne ne dispozicion te ortakut te vetem Z. ARBEN NDREKA , i cili mund t'i depozitoje ne Banke te vendit ose te huaj ,ne lek apo valute.

NENI 33

Pagesat e personelit behen sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e punes dhe te perqindjeve te fitimit te percaktuara nga ortakut i vetem.

NENI 34

Ne rast mbarimi te veprimtarise se shoqerise, fitimi i realizuar duke zbritur ose duke shtuar perqindjet e mbartura nga vitet e meparshme ,kalojne ne dispozicion te ortakut te vetem.

NENI 35

Cmimet e sherbimeve te ofruara nga Shoqeria si dhe ato te tregetit caktohen ne baze te ekonomise se tregut te lire. Fitimet e realizuara i nenshtrohen tatimit vjetor te percaktuar ne dipsozitat perkatese ligjore.

SHPERBERIA E SHOQERISE

NENI 36

Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te organit drejtues,ne rast se veprimtaria e saj nuk rezulton fitimprurese si dhe per shkaqet e parashikuara ne ligj.

NENI 37

Shoqeria mund te mbaroje edhe me ane te riorganizimit ,nepermjet formave te thithjes ose te bashkimit.

NENI 38



Gjatë fazes se likuidimit shoqeria,veprintaria financiare i kalon likujdatorit.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 39

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet ne ndonje institut sigurimin.

NENI 40

Mosmarreshjet ne mardhenie me persona juridike a fizike,vendas e te huaj zgjidhen me mirekuptim ,ne te kundert gjykata kompetente eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

NENI 41

Cdo gje tjeter ne kete shoqeri i referohet ligjii Nr. 7638 date 19.11.1992  
si dhe cdo akti tjeter te legjislacionit shqiptar.

NENI 42

Shoqeria do te kete vullen e saj forma dhe permbajtja e se ciles  
percaktohen nga ortaku i vetem.

Statuti i Shoqerise u miratua nga ortaku i vetem .  
saj dhe nenshkruhet regullisht.

**ORTAKU I VETEM**  
**ARBE ANDREKA**

